



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

VLORE

ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS

Nr. 1523/3 Prot.

Datë: 01/10/2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 29. 09. 2020

VENDIM

Nr. 90, datë 29. 09. 2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË KRITERIN E GJUHËS SË HUAJ PËR PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

Mbështetur në nenin 38, nenin 76 pika 4 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29. 09. 2020

VENDOSI:

1. Të miratojë fundin e vitit të parë akademik të studimeve si afatin për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj, për studentët e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2020-2021.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekanët e fakulteteve, Përgjegjësit e departamenteve, Kryesekretarët dhe sekretarët mësimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

